



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Departamenti i Procedurave dhe Teknologjisë së Informacionit
Adresa: Rruga “Gjin Bue Shpata“, Tiranë, SHQIPËRI

Nr. 16384 Prot

Tiranë, më 20.7.2012

Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore _____

Drejtoria e Auditit të Brendshëm
Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve
Drejtoria e Përpunimit dhe Kontabilitetit të të Ardhurave
Drejtoria e Mbledhjes së të Ardhurave
Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit
Drejtoria e Kontrollit Tatimor
Drejtoria e Hetimit Tatimor
Drejtoria e Ligjore
Drejtoria e Apelimit Tatimor
Sektorit Statistikës

Për dijeni: **Z. Afrim BRAHIMAJ** Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm
 Z. Pëllumb RAKIPI Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm
 Z. Besnik NUREDINI Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm

Lënda: Për vazhdimin e dorëzimit edhe në formë shkresore të listëpagesave dhe pasqyrave për ndryshimin e numrit të punonjësve

Nisur nga problemet e evidentuara dhe të grumbulluara gjatë periudhës nga fillimi i vitit, si dhe nga veshitëesia që kanë hasur një numër i madh subjektësh gjatë deklarimit nëpërmjet formës elektronike e të dhënave të listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe e të dhënave për ndryshimin e numrit të punonjësve, është dërguar për miratim Projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr.55, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, i ndryshuar”.

Projektvendimi i paraqitur për miratim ka për objekt zgjatjen për të gjitha periudhat tatimore të vitit 2012 të afatit të dorëzimit në organet tatimore edhe në formë shkresore të listëpagesave dhe pasqyrave për ndryshimin e numrit të punonjësve, brenda afateve ligjore, krahas deklarimit elektronik të këtyre të dhënave.

Porositeni veçanërisht të merni masat e nevojshme për njoftimin e tatimpaguesve që edhe për periudhat tatimore pas asaj qershor 2012 të vazhdojnë të dorëzojnë në organet tatimore edhe në formë shkresore listëpagesat dhe pasqyrat për ndryshimin e numrit të punonjësve, brenda afateve ligjore, krahas deklarimit elektronik të këtyre të dhënave.

Drejtoria e Shërbimit dhe Regjistrimit të Tatimpaguesve të marë masa për publikimin e kësaj shkrese në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve www.tatime.gov.al.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

GAZMIR SPAHIJA